

shpallje me: 08.12.2021
përduruesh me: 28



Në bazë të nenit 113 paragrafi 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fletorja zyrtare e MZ", nr 02/18, 034/19 dhe 038/20) dhe Vendimit mbi fillimin e procedurës për plotësimin e vendit të punës numër 09-032/21-14860 të datës 03.12.2021, Sekretariati për vetëqeverisje lokale- Zyra për burime njerëzore, **s h p a l l**

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

1. Ndhimës/e sekretari/ja e Sekretariatit për pronë i komunës së Tuzit

- Ekzekutues: 1, në kohëzgjatje të caktuar, person i cili kryen punët e kuadrit të lartë drejtues emërohet në periudhë prej 5 (pesë) vitesh;
- niveli i VIII i kualifikimit të arsimit;
- Fakulteti juridik, fakulteti i ndërtimtarisë ose arkitektonik;
- provimin profesional për punë në organet shtetërore (mardhënien e punës mund ta lidh dhe personi pa provimin profesional për punë në organet shtetërore, me kusht që ta përfundojë atë brenda një viti nga dita e lidhjes së mardhënies së punës;
- Më së paku dy vite përvoj pune në punet drejtuase ose katër vite përvojë pune;
- Njohja e punës në kompjuter;
- Njohja e gjuhës shqipe.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- formulari i paraqitjes në vend pune të lirë (Formulari i paraqitjes në vend pune të lirë kandidatët mund të nxjerrin në sajtin e komunës së Tuzit, www.tuzi.org.me ose drejtpërdrejtë në arkivin e Komunës së Tuzit),
- Curriculum Vitae – CV,
- fotokopja e letërnjoftimit biometrik,
- diploma ose vërtetim mbi përfundimin e nivelit dhe llojit të arsimit,
- vërtetimi i gjyqit kompetent që kundër kandidatit/tes nuk zhvillon procedurë penale sipas detyrës zyrtare,
- dëshmi (vërtetim) mbi përvojën e punës së kërkuar,
- vërtetim mbi provimin profesional të dhënë për punë në organet shtetërore.

Kandidatët janë të detyruar që Zyrës për burime njerëzore (në tekstin e mëtejme: Zyrja) të dorëzojnë me formularin e paraqitjes origjinal dokumentacionin ose fotokopjet e vërtetuara të dokumentacionit.

Me organin shtetëror nuk mund të lidh marrëdhënie pune personi i cili është shfrytëzues i të drejtës në pension, në përputhje me ligj.

Zyrtari shtetëror, gjegjësisht nëpunësi i cili ka realizuar të drejtë në dëmshpërblim nuk mund të lidh marrëdhënie pune në organin shtetëror ose personin juridik, në periudhë prej një viti nga dita e pagesës së dëmshpërblimit. Kufizimi nuk zbatohet për person që kthen të gjithë shumën e dëmshpërblimit të paguar.

